

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.N. nga Leposaviqi, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, av. L.P. dhe ankesës së të akuzuarit L.N., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.334/2015 datë 20.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 03.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me rastin e ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit D.N., av. L.P. e sipas detyrës zyrtare, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.334/2015 datë 20.02.2017 sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit L.N. për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK për të cilën është shpallur fajtor, dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve e merr si të vërtetuar dhe urdhëron që i njëjti të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Ankesa e të akuzuarit L.N., refuzohet si e pa bazuar.

III. Aktgjykimi i kundërshtuar në pjesën tjetër mbetet i pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.334/2015 datë 20.02.2017, të akuzuarin L.N. e ka shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK, dhe të njëjtin e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet brenda një (1) viti e katër (4) muajve, nëse i akuzuari gjatë kësaj periudhe kohore nuk kryen vepër penale. I dëmtuari D.N. është udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil. I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjekësore shumë prej 20€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kanë paraqitur:

- Përfaqësuesi i të dëmtuarit, av. L.P., për shkak të sanksionit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoi ankesën si të bazuar dhe të ligjshme, aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë dhe të akuzuarit ti shqipton dënim me burg efektiv.

- I akuzuari për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e të akuzuarit ta aprovojë si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj përkritazi me vendimin mbi dënimin dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë ose aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe vendim.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.421/2017 datë 13.04.2017, ka propozuar që ankesa e Përfaqësuesit të dëmtuarit, av. L.P. të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burg efektiv, ndërsa të refuzohet si e pabazuara ankesa e paraqitur nga i akuzuari.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesës së Përfaqësuesit të dëmtuarit, av. L.P. vlerëson se në rastin konkret aktgjykimi i kundërshtuar është përfshirë me shkelje të ligjit penal. Sipas nenit 51 par.2 të KPRK " Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse në personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet". Sipas dispozitës së lartcekur ligjore, rezulton se ekzekutimi i dënimin të shqiptuar me kusht shtyhet në vite të plota. Duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë në këtë rast të akuzuarit L.N. ia ka caktuar kohën e verifikimit për një (1) viti e katër (4) muaj, kjo Gjykatë eliminoi këtë shkelje të ligjit penal dhe të akuzuarit L.N. ia ndryshoi afatin e verifikimit në 2 (dy) vite, e me ndryshimin e këtij aktgjykimi për vendimin mbi dënimin, është evituar edhe shkelja e ligjit penal.

I akuzuari me ankesë ka theksuar se tani të dëmtuarin e ka lutë që mos t'ia maltretojë babain e sëmure dhe se i njëjti i është përgjigjur me sharje dhe kërcënim se edhe më tutje da ta rrahë babain e tij e nëse duhet edhe tani të akuzuarin duke u thirrë në gjykatën në të cilën punon dhe në faktin se në polici ka njerëzit e tij. Sipas ankesës, tani i dëmtuari ka qenë në efekt të alkoolit dhe se qëllimisht ka ardhë në fshat, duke e dijtë se i akuzuari është aty, për të nxitë përllamjen.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të të akuzuarit, nuk qëndrojnë. Sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejt pretendohet në ankesë. Se i akuzuari L.N. e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është gjykuar në pa mëdyshje nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar nga deklarata e dëshmitarit- të dëmtuarit D., pjesërisht edhe nga deklarata e të akuzuarit si dhe provave materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoi edhe kjo gjykatë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit me ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është shumë i butë. Me ankesë potencohet se gjykata e shkallës së parë, si rrethana rënduese në rastin konkret ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, ndjeshmërinë e rastit, faktin se vepra penale është kryer ndaj familjarit, se është cënuar integriteti fizik i të dëmtuarit si dhe fakti se i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore por sipas ankesës, gjykata e shkallës së parë i ka anashkaluar rrethanat tjera rënduese e që janë, se i akuzuari ka treguar këmbëngulësi sepse me veturën e tij e ka zënë rrugën nëpër të cilën ka kaluari dëmtuari dhe e ka pamundësuar që eventualisht i dëmtuari të ikë nga vendi i ngjarjes për ti ikë rrahjes, se i dëmtuari D. është person i hendikepuar, është i verbër në një sy dhe çalon me një këmbë, për çka i akuzuari ka qenë i njoftuar dhe e ka shfrytëzuar faktin se i dëmtuari nuk është në mundësi që të mbrohet.

I akuzuari me ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar ndaj tij është i lartë, konsideron se nëse mbetet në fuqi dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, i dëmtuari do ta shfrytëzojë këtë për provokime të përditshme dhe ngacmime për shkaktimin e mosmarrëveshjeve tjera, që si pasojë të kenë zëvendësimin e dënimit me kusht me burg efektiv.

Duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më lartë, kjo Gjykatë për shkak të shkeljes së ligjit penal e ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe të akuzuarit i shqiptoi dënim me kusht më të gjatë se në dispozitiv të aktgjykimit të kundërshtuar, me çka eliminoi shkeljen e ligjit, me të cilën ishte përfshirë aktgjykimi i ankimuar dhe aprovoi ankesën e përfaqësuesit të të dëmtuarit, me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit dhe se ky dënim është në harmoni me përgjegjësinë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventivës gjeneralë dhe individuale dhe se me këtë dënim do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit, i paraparë me dispozitat ligjore.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.398/17, me 03.05.2017

Bashkëpunëtori profesional,
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
1. Rasim Rasimi

Anëtarët e kolegjit:
2. Shqipe Qerimi
3. Gani Zabeli